



KAPITULLI

# 23

---

GJYQËSORI DHE  
TË DREJTAT THEMELORE

# Dëftesa E Progresit Dhe Nivelit Të Përgatitjes Së Shqipërisë Drejt Anëtarësimit Në Bashkimin European Gjatë Vitis 2021

Ky punim u përgatit nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) në kuadër të projektit "Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri", me mbështetjen financiare të Bashkimit European nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit European në Shqipëri. Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit European.

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri (QKB), është një iniciativë e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim zbatuar në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA).

tetor 2022 Tiranë

# Dëftesa E Progresit Dhe Nivelit Të Përgatitjes Së Shqipërisë Drejt Anëtarësimit Në Bashkimin European Gjatë Vtit 2021

SIPAS VLERËSIMEVE TË RAPORTEVE TË KOMISIONIT EUROPIAN 2021 DHE 2022

## KONTEKSTI

Komisioni European (KE) monitoron progresin dhe nivelin e përgatitjes së Shqipërisë në përbushjen e kërkesave të anëtarësimit mbi një bazë vjetore. Vendi po punon për transpozimin e Acquis sipas Planit Kombëtar të Integrimit European (PKIE) i cili shërben si mjet për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA). Mbajtja e Konferencës së Parë Ndërqeveritare, më 19 korrik 2022 ishte një ngjarje historike për vendin tonë pasi mishëron aspektin teknik të procesit të integrimit në BE. Konferenca hapi rrugën për miratimin e kuadrit negociator të hartuar nga Komisioni European dhe hapjen e kapitujve të Grupimit të Parë të njojur edhe si "Themeloret".

Kjo Dëftesë mbi Progresin dhe Nivelin e Përgatitjes së Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE merr si pikënisje gjendjen e përshkruar në Raportin e KE 2021 dhe pasqyron zhvillimin gjatë një viti, kristalizuar në Raportin e KE 2022. Ajo synon të shfaqë në një gjuhë më të lexueshme 1) Kriterin politik; 2) Kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore) dhe 3) Kapitullin 24 (Drejtësia, Liria, Siguria).

Dëftesa paraqet një vlerësim për çdo nënçështje të secilit kapitull. Vlerësimi përfshin një shtjellim të progresit dhe përgatitjes gjatë vitit 2021 në se cilën fushë, si dhe një vlerësim me notë (ku 10 është nota më e lartë dhe 4 më e ulëta), ku merr parasysh terminologjinë e përdorur në çdo rast në Raportet e Komisionit European për progresin dhe nivelin e përgatitjes.

Për më tepër, merr në konsideratë shpeshtësinë me të cilën ajo është përdorur, kombinuar me rëndësinë e çështjes (për shembull, nismat e reja ligjore apo strategjitet përgjithësisht janë vlerësuar më të rëndësishme se trajnimet rutinë apo përmirësimet modeste në kapacitete). Fokus i veçantë i është dhënë vlerësimit të zbatimit të legjislacionit si një nga problemet më të rëndësishme që has vendi ynë. Metodologjia e aplikuar nga EMA përbën një fotografim të disa përbërësve që formësojnë një nënëfushë, fushë e më pas kapitullin.

TERMINOLOGJIA E PËRDORUR PËR PROGRESIN	NOTA
Hapa mbrapa (Backsliding)	4
Mungon progresi (No progress)	5
Progres i kufizuar (Limited Progress)	6
Njëfarë progresi (Some progress)	7
Progres i mirë (Good Progress)	8-9
Progres shumë i mirë (Very good progress)	10

TERMINOLOGIA E PËRDORUR PËR PËRGATITJEN	NOTA
n/a	n/a
Fazë e hershme (Early stage)	5
Njëfarë nivel i përgatitje (Some level of preparation)	6
Njëfarë nivel / Përgatitje mesatare (Some level / moderately prepared)	7
Përgatitje mesatare (Moderately prepared)	8
Nivel i mirë përgatitjeje (Good level of preparation)	9
Nivel i përparuar përgatitjeje (Well-advanced)	10

### Si Duhet Lexuar Dëftesa?

Dëftesa e Shqipërisë paraqet notat për çdo fushë, në bazë të analizës nga Komisioni European për progresin dhe përgatitjen e bërë apo të munguar në procesin e integrimit european gjatë vittit 2020 dhe 2021. Vlerësimi i fushave është realizuar duke marrë parasysh disa kritere si:

- Vlerësimi i përbushjes së kërkesave dhe detyrimeve që burojnë nga procesi në kuadër të hartimit të legjislacionit.
- Vlerësimi i ecurisë së procesit duke u nisur nga gjetjet e raportit të vjetshëm me zhvillimet brenda 1 viti.
- Marrja parasysh ose jo e rekomandimeve të një viti më parë.

Nëpërmjet kësaj Dëftese, synohet t'u ofrohet aktorëve të shoqërisë civile, akademikëve, punonjësve të administratës, studentëve, bizneseve dhe çdo qytetari të interesuar një lexicim i qartë dhe i saktë, përtej debateve politike i përparimit të Shqipërisë në të gjitha fushat pjesë të Kritereve të Kopenhagenit për anëtarësim në BE.

## DËFTESA PËR KAPITULLIN 23

Kapitulli 23 Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore	RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2021	RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2022	
Funksionimi i gjyqësorit	<p><b>Përgatitja – Nota: 8</b></p> <p>Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë dhe Plani i saj i Veprimit 2021-2025 <b>duhet</b> të miratohen në kohë. Mekanizmat koordinues dhe transparencë <b>duhet të rriten</b> në institucionet e drejtësisë. Ndryshimet kushtetuese dhe ligjore kanë <b>reduktuar</b> ndikimin politik gjatë procesit të emérimit, duke siguruar një sistem përzgjedhje të bazuar në merita. <b>Nevojiten përpjekje të mëtejshme</b> nga Shkolla e Magjistraturës për të përforcuar stafin e saj akademik dhe për të siguruar procedura konkurruese dhe transparente të rekrutimit. Struktura e Specializuar Kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), e përbërë nga Prokuroria e Posaqme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit <b>janë funksionale</b> - kusht për Konferencën e Parë Ndërqeveritare që <b>vijon të plotësohet</b>.</p>	<p><b>Përgatitja – Nota: 8</b></p> <p>Strategjia e Re Ndërsektorale e Drejtësisë dhe Plani i saj i Veprimit 2021-2025 <b>janë miratuar</b> nga Këshilli i Ministrave dhe <b>duhet të zbatohet</b> në mënyrë të fryshtshme. Koordinimi i mëtejshëm i institucioneve të drejtësisë <b>vazhdon</b> të jetë i nevojshëm. Zbatimi i vazhdueshëm i reformës në drejtësi <b>reduktoi më tej</b> ndikimin politik gjatë gjithë procesit të emérimit, duke siguruar kështu një sistem rekrutimi të bazuar në merita. Shkolla e Magjistraturës <b>duhet të fuqizojë</b> stafin akademik dhe të sigurojë procedura rekrutimi konkurruese dhe transparente. Struktura e Specializuar Kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), e përbërë nga Prokuroria e Posaqme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit <b>vazhdojnë të jenë funksionale</b>.</p>	0
	<p><b>Progresi – Nota: 7</b></p> <p>Shqipëria <b>ka vazhduar</b> me zbatimin e reformës gjithëpërfshirëse në drejtësi, duke rezultuar në <b>një progres të mirë</b>. Rivlerësimi gjithëpërfshirës kalimtar i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve (vetting) <b>përparoi</b> në mënyrë të qëndrueshme dhe dha rezultate të prekshme. Institucionet vetëqeverisëse të gjyqësorit <b>kanë vazhduar</b> të jenë plotësisht funksionale. Përpjekja për ndërryrje të brendshme dhe të jashtme në sistemin gjyqësor <b>vazhdon</b> të mbetet një çështje shqetësuese. <b>Duhet të ndërmerrin hapa</b> vendimtarë dhe të shpejtë drejt zhvillimit të një sistemi të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve,</p>	<p><b>Progresi – Nota: 7</b></p> <p>Reforma gjithëpërfshirëse në drejtësi <b>vazhdoi</b> duke rezultuar në <b>një progres të mirë</b> në përgjithësi. Rivlerësimi gjithëpërfshirës kalimtar (vetting) i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve <b>vazhdoi të përparoje</b> me një ritëm të qëndrueshëm. Institucionet vetëqeverisëse të gjyqësorit <b>kanë vazhduar</b> të ushtrojnë plotësisht funksionet e tyre. <b>Vazhdojnë</b> të ngrihen <b>shqetësime</b> rrëth përpjekjeve të supozuara për të ndërrhyrë dhe ushtruar presion mbi sistemin gjyqësor. Sistemi modern i Integruar i Menaxhimit të Çështjeve <b>ka qenë në pritje</b> për tu zhvilluar për shumë vite dhe është i nevojshëm për të përmirësuar efikasitetin dhe transparencën e sistemit të drejtësisë.</p>	0

Kapitulli 23  
Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore

RAPORTI I KOMISIONIT  
EUROPIAN 2021

RAPORTI I KOMISIONIT  
EUROPIAN 2022

Lufta kundër korruptionit	<p>për të rritur efikasitetin dhe transparencën e sistemit të drejtësisë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë <b>ka kryer plotësisht</b> funksionet e tij. Infrastruktura e gjykatave <b>mbetet e dobët</b>. Një hartë e re gjyqësore <b>duhet të miratohet urgjentisht</b> dhe të zbatohet për të rishpërndarë gjyqtarët dhe burimet brenda sistemit gjyqësor.</p>	<p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë <b>ka vazhduar të jetë plotësisht funksional</b>. Infrastruktura e gjykatave <b>mbetet e dobët</b>. Do të <b>nevojitet</b> një plan solid <b>zbatimi</b> për hartën e re gjyqësore.</p>	0
	<p><b>Përgatitja – Nota: 8</b></p> <p>U bënë <b>përpjekje të mëtejshme</b> për sa i përket hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimive në luftën kundër korruptionit. Vettingu i anëtarëve të drejtësisë <b>ka vijuar</b> të ketë një ndikim pozitiv në luftën kundër korruptionit. Legislacioni dytësor i lidhur me integritetin eshtë në fuqi, <b>por ende nuk eshtë krijuar</b> një sistem i përgjithshëm i menaxhimit të rrezikut të integritetit për korruptionin. Në përgjithësi zbatimi i Strategjisë Ndërsektorale kundër Korruptionit <b>eshtë</b> në rrugën e duhur, megjithëse disa probleme <b>vazhdojnë</b>.</p>	<p><b>Përgatitja – Nota: 8</b></p> <p><b>Përpjekjet vazhduan</b> për përmirësimin e e hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimive në luftën kundër korruptionit. Vettingu i anëtarëve të drejtësisë <b>ka vijuar</b> të ketë një ndikim pozitiv në luftën kundër korruptionit. 12 institucionet dhe agjencitë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë <b>kanë finalizuar</b> procesin e vlerësimit të rrezikut të integritetit dhe <b>kanë miratuar</b> planet e tyre të integritetit. Në përgjithësi, zbatimi i Strategjisë Ndërsektorale kundër Korruptionit vazhdon të jetë në rrugën e duhur.</p>	0
	<p><b>Progresi – Nota: 7</b></p> <p><b>Nevojiten</b> përpjekje të vazhdueshme për të luftuar kulturën e mosndëshkimit brenda niveleve më të larta të shtetit. Zbatimi i Ligjit për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve <b>vazhdoi</b>. Ndikimi i masave kundër korruptionit në fusha si: dogana, administrata tatimore, arsimi, shëndetësia, prokurimet publike, kontratat PPP etj. <b>mbetet i kufizuar</b>. Incidentet e ndodhura gjatë fushatës zgjedhore, veçanërisht në lidhje me blerjen e votave, kanë nxjerrë në pah <b>nevojën</b> për transparencë në financimin e partive politike.</p>	<p><b>Progresi – Nota: 7</b></p> <p><b>Nevojiten</b> përpjekje të vazhdueshme për të luftuar kulturën e mosndëshkimit brenda niveleve më të larta të shtetit. Ligji për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve <b>vazhdoi të zbatohet</b>. Masat kundër korruptionit në fusha si: dogana, administrata tatimore, arsimi, shëndetësia, prokurimet publike, kontratat PPP etj. vazhdojnë të kenë një ndikim <b>të kufizuar</b>. Incidentet, të lidhura me praktikat e blerjes së votave në zgjedhjet e prillit 2021, <b>konfirmuan</b> nevojën për financa më transparente të partive politike në përputhje me standarde ndërkombëtare dhe europiane.</p>	0

Kapitulli 23  
Gjyqësori dhe të  
Drejtat Themelore

RAPORTI I KOMISIONIT  
EUROPIAN 2021

RAPORTI I KOMISIONIT  
EUROPIAN 2022

**Përgatitja – Nota: 7**

Protokolli Fakultativ i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokolli Fakultativ i Konventës Ndërkombejtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore **janë në pritje** për tu nënshkruar që nga viti 2019. Avokati i Popullit **rriti ndjeshëm** numrin e rasteve të trajtuar dhe shtoi numrin e rekomandimeve drejt pushtetit qendor dhe vendor për marrjen e masave konkrete për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore. Sipas rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtërues **nevojiten** përmirësimë të mëtejshme në funksionimin e objekteve të paraburgimit. **Vazhdojnë përpjekjet** për harmonizimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënavë personale me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënavë Personale 2016/679 dhe Direktivën e Policisë 2016/680. Praktika e martesës së fëmijëve **është ende** e pranishme në Shqipëri, veçanërisht në komunitetet rome, egjiptiane dhe në zonat rurale.

**Përgatitja – Nota: 7**

Protokolli Fakultativ i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokolli Fakultativ i Konventës Ndërkombejtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore **nuk janë nënshkruar** ende. Avokati i Popullit **vazhdoi** të promovojë dhe forcojë zbatimin e të drejtave të njeriut. Objektet e paraburgimit **vazhdojnë** të kenë kushte të këqija dhe **mangësi** strukturore. Legjislacioni për mbrojtjen e të dhënavë personale **duhet të vazhdojë** të përafrohet më tej me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënavë dhe direktivën përkatëse të "zbatimit të ligjit". Ligjet për mbrojtjen e adoleshentëve nga martesat e fëmijëve janë **jofektive**.

0

**Progresi – Nota: 7**

Shqipëria **përputhet** në përgjithësi me instrumentet ndërkombejtare të të drejtave të njeriut dhe **ka ratifikuar** shumicën e konvantave ndërkombejtare. Shqipëria **vazhdon** të ketë bashkëpunim të mirë me Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Gjatë periudhës raportuese, **prokuroritë nuk kanë kryer** asnjë hetim ex officio për çështjet e personave të zhdukur gjatë kohës së komunizmit. Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënavë Personale **duhet t'i caktohet** staf shtesë në mënyrë që ai të përmbushë detyrat e shtuara. Në përgjithësi, liria e mendimit dhe fesë **u respektua**.

**Progresi – Nota: 7**

Në përgjithësi, Shqipëria **përputhet** me instrumentet ndërkombejtare të të drejtave të njeriut dhe **ka ratifikuar** shumicën e konvantave ndërkombejtare. Shqipëria vazhdon të ketë bashkëpunim të mirë me Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Është bërë **progres i kufizuar** në hetimin e rasteve dhe forcimin e kuadrit institucional dhe legjislativ për personat e zhdukur që nga koha e komunizmit. Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënavë Personale **duhet t'i caktohet** staf dhe burime financiare shtesë në mënyrë që ai të përmbushë detyrat e shtuara. Në përgjithësi, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë **u mbështet**.

0

Kapitulli 23  
Gjyqësori dhe të  
Drejtat Themelore

RAPORTI I KOMISIONIT  
EUROPIAN 2021

RAPORTI I KOMISIONIT  
EUROPIAN 2022

Liria e shprehjes	<p><b>Përgatitja – Nota: 6</b></p> <p>Shqipëria <b>ka nevojë</b> ende për legjislacion për forcimin e transparencës në reklamat publike. Raportet e organizatave për lirinë e medias tregojnë se aktorët politikë përdorin gjithnjë e më shumë rrjetet sociale për të komunikuar me votuesit, ndërkokë që kufizojnë aksesin tek reporterët dhe anashkalojnë mediat kritike – duke <b>reduktuar</b> rolin e mbikëqyrësve publikë. <b>Nevojitet</b> zbatim më i mirë dhe ndërgjegjësim më i madh për të eliminuar gjuhën eurrejtjes, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta.</p>	<p><b>Përgatitja – Nota: 6</b></p> <p>Shqipëria <b>ka ende nevojë</b> të prezantojë legjislacionin për të forcuar transparencën e reklamat publike. Mediat dixhitale <b>janë ende</b> nën ndikim të fortë të aktorëve politikë, bizneseve dhe palëve të treta për sa i përket financimit dhe përbajtjes. <b>Nevojitet</b> zbatim më i mirë dhe ndërgjegjësim më i madh për të eliminuar gjuhën eurrejtjes, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta.</p>	0
	<p><b>Progresi – Nota: 5</b></p> <p>Vazhdon <b>shqetësimi</b> serioz midis organizatave për lirinë e medias <b>për presionin politik</b>, përdorimin e gjuhës kërcënuese dhe dhunën ndaj gazetarëve. Ndikimi i fortë i politikës dhe biznesit mbi median <b>mbetet</b> një burim <b>kryq shqetësimi</b> për lirinë e shprehjes në vend.</p>	<p><b>Progresi – Nota: 5</b></p> <p>Aktorët politikë <b>vazhduan</b> të përdornin gjuhë denigruese kundër gazetarëve. Atmosfera e sulmeve verbale, fushatave shpifëse dhe akteve të frikësimit ndaj gazetarëve <b>nuk është përmirësuar</b>. Përqendrimi i tregut dhe i audiencës dhe mungesa e transparencës së financimit të medias vazhdojnë të <b>mbeten çështje shqetësuese</b> për sa i përket lirisë së medias në vend.</p>	0
Barazia gjinore/ mosdiskriminimi	<p><b>Përgatitja – Nota: 6</b></p> <p>Ligji për shëndetin riprodhues <b>ka mungesa</b> për mekanizmat e referimit ndërmjet niveleve të ndryshme të kujdesit. Shqipëria <b>ka bërë progres</b> në ngritjen e një kuadri ligjor që rregullon të drejtat e fëmijëve. Mungesa e zbatimit dhe mjeteve të kompensimit të duhur për shkeljet e të drejtave <b>mbetet shqetësuese</b>. <b>Nevojiten</b> përpjekje të mëtejshme, për të trajtuar dhunën ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe për të mbledhur të dhëna statistikore përgjendjen e tyre. Një dispozitë e Ligjit për Shtetësinë e miratuar në korrik 2020 <b>mund të vazhdojë</b> të çojë në krijimin e skemave që paraqesin rreziqe që kanë të bëjnë me sigurinë, pastrimin e parave, evazionin fiskal,</p>	<p><b>Përgatitja – Nota: 6</b></p> <p>Ligji për shëndetin riprodhues <b>ka mungesa</b> për mekanizmat e referimit ndërmjet niveleve të ndryshme të kujdesit. Është bërë <b>njëfarë progresi</b> në ngritjen e kapaciteteve institucionale për zbatimin efektiv të kuadrit ligjor që rregullon të drejtat e fëmijëve. <b>Nevojiten përpjekje</b> më të fuqishme për të trajtuar diskriminimin dhe dhunën ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe për të mbledhur të dhëna statistikore përgjendjen e tyre. Një dispozitë e Ligjit për Shtetësinë e miratuar në korrik 2020 <b>mund të vazhdojë</b> të çojë në krijimin e skemave që paraqesin rreziqe që kanë të bëjnë me sigurinë, pastrimin e parave, evazionin fiskal,</p>	0

Kapitulli 23  
Gjyqësori dhe të  
Drejtat Themelore

RAPORTI I KOMISIONIT  
EUROPIAN 2021

RAPORTI I KOMISIONIT  
EUROPIAN 2022

	<p>Një dispozitë e Ligjit për Shtetësinë e miratuar në korrik 2020 mund të vazhdojë të çojë në krijimin e skemave që paraqesin rreziqe që kanë të bëjnë me sigurinë, pastrimin e parave, evazionin fiskal, financimin e terrorizmit, korruptionin dhe infiltrimin nga krimi i organizuar dhe <b>nuk përputhet</b> me Acquis e BE-së.</p>	<p>financimin e terrorizmit, korruptionin dhe infiltrimin nga krimi i organizuar dhe <b>nuk përputhet</b> me Acquis e BE-së.</p>	0
	<p><b>Progresi – Nota: 6</b></p> <p>Për sa i përket mosdiskriminimit, korniza ligjore dhe e politikave në përgjithësi <b>është përafruar</b> me standardet e BE-së dhe <b>është përmirësuar</b> më tej me ndryshimet në Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi. Në vitin 2020, u bënë përpjekje <b>për të rritur</b> fondet publike përviktimat e dhunës në familje. Legjislacioni kuadër i Shqipërisë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara është <b>pjesërisht</b> në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Diskriminimi ndaj komunitetit (LGBT) <b>mbetet i përhapur</b> dhe dominues në shoqërinë shqiptare. Legjislacioni i mbetur për vetë-identifikimin dhe përdorimin e gjuhëve të pakicave kombëtare, <b>ende nuk është miratuar</b>.</p>	<p><b>Progresi – Nota: 6</b></p> <p>Për sa i përket mosdiskriminimit, korniza ligjore dhe e politikave në përgjithësi <b>është përafruar</b> me standardet e BE-së. Ka mangësi në riintegrinë e personave të dhunuar. <b>Nuk është bërë progres</b> në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Legjislacioni kuadër i Shqipërisë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara është pjesërisht në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Në shoqërinë shqiptare, diskriminimi ndaj personave (LGBT) <b>është ende shumë i përhapur</b>. Legjislacioni zbatues për çështjet vendimtare të vetëidentifikimit të lirë të pakicave kombëtare dhe përdorimi i gjuhëve <b>mbetet për t'u miratuar</b>.</p>	0